



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:153346

Datë: 20.08.2024

Numri i dokumentit: 06066699

PKR.nr.203/2005

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues Fatos Sejdiqaj, me bashkëpunëtoren profesionale Donjeta Tahiri, në çështjen penale ndaj të pandehurve : E.H., G.D.dhe M.A.në bashkëkryerje me NN persona për shkak të veprave penale I. Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25 (tutje:KPPK) dhe II. Detyrimi nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 23 të KPPK-së, në bashkim real me veprën penale në pikën 1 të këtij dispozitivi, duke vendosur sipas aktakuzës së ish-Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.47/2005, të datës 03.05.2005, sipas detyrës zyrtare me datën 20.08.2024, mori këtë :

A K T V E N D I M

I.- HEDHET aktakuza e ish-Prokurorisë Publike të Qarkut, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.47/2005, e datës 03.05.2005, dhe **pushohet** procedura penale ndaj të pandehurve :

I.1 - E.H., nga i ati, e ëma, lindur më datë në fshatin, komuna e Vushtrrisë, ku edhe jeton, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I.2 – G.D., nga i ati, e ëma, lindur më datë në Prishtinë, tani me vendbanim në Graçanicë në rrugën “.....”, me numër personal, shtetas i Republikës së Kosovës.

I.3 – M.A., me nofkën “.....” nga i ati, e ëma, lindur më datë në, tani me vendbanim në Graçanicë, me numër personal, serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

- Për veprën penale : Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, **për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale ndërsa,**

- Për veprën penale : Detyrimi nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 23 të KPPK-së, **për shkak të parashkrimit relativ të ndjekjes penale.**

II.- Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

III.- Pala e dëmtuar, E.A. nga fshati, Komuna e Vushtrrisë, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

- Ish-Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën PP.nr.47/2005, të datës 03.05.2005, ndaj të pandehurve E.H., G.D.dhe M.A. në bashkëkryerje me NN persona për shkak të veprave penale I. Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së dhe II. Detyrimi nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 23 të KPPK-së, në bashkim real me veprën penale në pikën 1 të këtij dispozitivi.

- Këtë lëndë penale Kryetari i Trupit Gjykses e ka pranuar me datën 19.01.2024 dhe pasi që ka pranuar të njëjtën duke shikuar në shkresat e lëndës ka vërejtur se, në këtë çështje penale për veprën penale si në pikën –I- të dispozitivit të aktakuzës -Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së për të cilën akuzohen të pandehurit, ka arritur afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale, ndërsa për veprën penale si në pikën –II- të dispozitivit të aktakuzës-Detyrimi nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 23 të KPPK-së, ka arritur afati i parashkrimit relativ të ndjekjes penale.

- Gjetjet e Gjykatës në raport me pikën –I- të aktakuzës -

- Në nenin 90 par.1, nënpar.4 të KPPK-së, është përcaktuar se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar pesë (5) vjet nga koha e kryerjes së veprës penale të dënueshme me shumë se tre (3) vjet burgim. Ndërsa, sipas nenit 91 par.6 të KPPK-së, është përcaktuar se ndjekja penale ndalohe në çdo rast kur të **ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.**

- Në rastin konkret të pandehurit E.H., G.D. dhe M.A. janë akuzuar për kryerjen e veprës penale-Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, për të cilën vepër penale parashihet dënim me burgim prej gjashtë (6) muajve deri në pesë (5) vjet.

- Sipas aktakuzës, të pandehurit këtë vepër penale dyshohen ta kenë kryer me datën 30-31.01.2005, dhe sipas kësaj ka kaluar dyfishi i afatit të parashkrimit të paraparë për këtë vepër penale dhe në bazë

të nenit 91 par.6 të KPPK-së, në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrimin absolut të ndjekjes penale, e që në këtë rast nga data 31.01.2005 deri me datën 31.01.2015 rezulton se kanë kaluar dhjetë (10) vite, pra ka kaluar dyfishi i kohës që kërkohet për arritjen e parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

- Gjetjet e Gjykatës në raport me pikën –II- të aktakuzës -

Në nenin 90, paragrafi 1, nën-paragrafi 3 të KPPK-së, përcaktohet se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar: “*dhjetë (10) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim*”. Ndërkaq, sipas nenit 91, par.1 të KPPK-së, “*afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedh nga dita kur është kryer vepra penale*”, paragrafi 3 përcakton: “*Afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale të kryer*”, ndërsa paragrafi 4 parasheh: “*Afati i parashkrimit ndërpritet po ashtu kur kryerësi kryen një vepër tjetër penale me peshë të barabartë ose më të rëndë se sa vepra penale para skadimit të afatit të parashkrimit*”.

Gjykata, nga shkresat dhe provat që gjenden në këtë lëndë penale si dhe nga rrethanat e këtij rasti, konstaton se nuk është paraqitur asnjë nga rrethanat që do të ndalonte rrjedhën e parashkrimit të ndjekjes penale, në afatin dhjetë (10) vjeçar, afat ky i paraparë për parashkrim relativ për këtë vepër penale.

Në rastin konkret të pandehurit janë akuzuar për kryerjen e veprës penale- Detyrimi nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 23 të KPPK-së, për të cilën vepër penale parashihet dënimi me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Sipas aktakuzës, të pandehurit këtë vepër penale dyshohet ta kenë kryer me datën 31.01.2005, ndërsa veprimi i fundit i ndërmarrë në drejtim të ndjekjes penale është ndërmarrë më datë 09.11.2005, datë kjo sipas konstatimit të fletkthesës së gjykatës kur është pranuar Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P.nr.203/2005 i datës 15.09.2005 për konfirmimin e aktakuzës, nga Mbrojtësi i të pandehurit M.A., Av.Refik Sofoviq pasi që kundër të njëjtit nuk ishte parashtruar ankesë, dhe nga kjo datë, pra data 09.11.2005 e deri më tani, nuk është ndërmarr asnjë veprim në drejtim të ndjekjes penal.

Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se nga data 09.11.2005, datë kur është pranuar Aktvendimi për konfirmimin e aktakuzës, e deri me tani kanë kaluar më shumë se tetëmbëdhjetë (18) vjet, dhe se brenda kësaj periudhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim me qëllim të ndjekjes penale, që do të

ndërpriste rrjedhën e afatit të përshkrimit relativ, çka do të thotë se ka arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale në bazë të nenit 90, par. 1, nënpar.3 të KPPK-së.

- Saktësisht, parashkrimi relativ i ndjekjes penale në këtë rast penal ka arritur me datë 09.11.2015, ditë kjo kur janë mbushur dhjetë (10) vjet nga dita kur është ndërmarrë veprimi i fundit në drejtim të ndjekjes penale, ngase brenda kësaj periudhe kohore nuk është ndërprerë rrjedha e afatit të parashkrimit dhe nuk ka përfunduar ndjekja penale.

Gjykata, bazuar në verifikimet që janë bërë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, përmes Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve njoftuar me parashtresën me shkrim P.nr.203/2005 të datës 28.06.2024, ka vërtetuar se ndaj të pandehurit E.H. përveç kësaj lënde, janë zhvilluar edhe procedura tjera, respektivisht rezulton i dënuar me aktgjykim të formës së prerë në këto raste :

- a. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.1611/2008 i plotfuqishëm me datë 24.12.2010, për veprën penale-Falsifikim i dokumentit nga neni 332 par.3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25, për të cilën është paraparë dënim me gjobë ose me burgim deri në tri (3) vjet.
- b. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.225/2001 i plotfuqishëm me datë 26.02.2004, për veprën penale-Fshehja nga neni 154 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës 1977, për të cilën është paraparë dënim me burgim prej tre (3) deri në pesë (5) vjet,

Ndërsa ndaj të pandehurit G.D., Gjykata ka vërtetuar se përveç kësaj lëndë, janë zhvilluar edhe procedura tjera, respektivisht rezulton i dënuar me aktgjykim të formës së prerë në këto raste:

- a. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.979/2013 i plotfuqishëm me datë 15.02.2018, për veprën penale-Rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par.5 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25, për të cilën është paraparë dënim me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
- b. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.1394/2011 i plotfuqishëm me datë 23.08.2012, për veprën penale-Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.4 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25, për të cilën është paraparë dënim me burgim prej gjashtë (6) muajsh deri në tre (3) vjet.
- c. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.338/2007 i plotfuqishëm me datë 26.09.2008, për veprën penale-Mashtrimi nga neni 261 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal

të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25, për të cilën është paraparë dënim gjobë apo me burgim deri në tri (3) vjet.

- d. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2656/2005 i plotfuqishëm me datë 27.12.2007, për veprën penale-Falsifikim i dokumentit nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25, për të cilën është paraparë dënim me gjobë ose me burgim deri në tri (3) vjet.
- e. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.736/2005 i plotfuqishëm me datë 14.06.2007, për veprën penale-Mashtrimi nga neni 261 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25, për të cilën është paraparë dënim gjobë apo me burgim deri në tri (3) vjet.
- f. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2285/2006 i plotfuqishëm me datë 28.07.2011, për veprën penale-Falsifikim i dokumentit nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25, për të cilën është paraparë dënim me gjobë ose me burgim deri në tri (3) vjet.
- g. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.843/2010 i plotfuqishëm me datë 21.11.2014, për veprën penale-Rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par.1, 3 dhe 5 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25, për të cilën është paraparë dënim burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Ndërsa ndaj të pandehurit M.A. Gjykata ka vërtetuar se përveç kësaj lënde, janë zhvilluar edhe procedura tjera, respektivisht rezulton i dënuar me aktgjykim të formës së prerë në këto raste :

- a. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.124/2006 i plotfuqishëm me datë 23.06.2009, për veprën penale-Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 316 par.3 lidhur me par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25, për të cilën është paraparë dënim me burim tre (3) muajve deri në pesë (5) vjet.
- b. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.486/2007 i plotfuqishëm me datë 22.06.2007, për veprën penale-Pranimi i mallrave ë vjedhura nga neni 272 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25, për të cilën është paraparë dënim me burgim deri në një (1) vit.
- c. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Gracanicë, P.nr.6/2020 i plotfuqishëm me datë 30.10.2020, për veprën penale-Rrezikim i trafikut publik nga neni 378

par.8 sipas Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, për të cilën është paraparë dënim me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

- d. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.148/2021 i plotfuqishëm me datë 23.12.2022, për veprën penale-Sulmi nga neni 184 par.1 sipas Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, për të cilën është paraparë dënim me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Megjithatë, pavarësisht se këta të pandehur janë dënuar me aktgjykime të formës së prerë në raste tjera, Gjykata konstaton se asnjëra nga këto raste nuk e kanë ndërprerë rrjedhën e afatit të parashkrimit relativ të ndjekjes penale.

Bazuar në nenin 91, par. 4 të KPK-së, rrjedhë se afati i parashkrimit ndërpritet kur kryerësi kryen një veprë tjetër penale **me peshë të barabartë ose më të rëndë se sa vepra penale para skadimit të afatit të parashkrimit**. Referuar aktgjykimeve me të cilat janë dënuar, e të cekura më lartë, të gjitha veprat për të cilat janë dënuar **nuk janë me peshë të barabartë e as më të rëndë me veprën penale sipas pikës –II- të kësaj aktakuze**. Të gjitha këto vepra për të cilat të pandehurit janë dënuar kanë dënueshmëri më të ultë, që nënkupton se këto vepra penale nuk e kanë ndalur rrjedhën e afatit të parashkrimit.

- Gjykata konstaton se parashkrimi relativ dhe absolut i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale ashtu që, pamundëson ligjërisht që Gjykata të ndërmerre ndonjë veprim në drejtim të ndjekjes penale e për pasojë është rrethanë që pengon ndjekjen penale, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi që të hedh aktakuzën e ish-Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.47/2005, të datës 03.05.2005 dhe të pushojë procedurën penale ndaj të pandehurve E.H., G.D.dhe M.A., për veprën penale-Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, ndërsa për veprën penale Detyrimi nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 23 të KPPK-së, për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit relativ të ndjekjes penale.

- Aktvendimin mbi parashkrimin absolut Gjykata e mori në kuptim të nenit 90 par.1, nënpar.4 dhe nenit 91 par.6 të KPPK-së, lidhur me nenin 357 par.1, nën par.1.3 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale (KPP).

- Aktvendimin mbi parashkrimin relativ Gjykata e mori në kuptim të nenit 90 par.1, nënpar.3 të KPPK-së, lidhur me nenin 357 par.1, nën par.1.3 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale (KPP).
- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 453 par. 1 të KPP-së.
- Vendimin mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, e mori në kuptim të dispozitës ligjore nga neni 462 par.1 dhe par.3 të KPP-së.
- Nga arsyet e lartcekura e në kuptim të nenit 91 par.6 dhe nenit 90 par.1, nënpar 3 dhe 4, e lidhur me nenin 357 par. 1, nën par.1.3 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.203/2005, me datë 20.08.2024

Kryetari i Trupit Gjykes,

Fatos Sejdijaj

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar në afatin prej tre (3) ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.